



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 332/2 Prot.

Tiranë, më 13.07.2016

V E N D I M
Nr. 79, datë 13.07.2016

*“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit,
filluar me Urdhrin nr. 332 prot., datë 18.04.2016”*

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1 dhe nenet 14 e 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”, referuar nenit 185, të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Mbikëqyrjes dhe Inspektimit, në përfundim të procedurës së verifikimit,

VËREJ SE :

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas marrjes dijeni nga informacioni i dërguar prej Bashkisë Tepelenë, për disa parregullsi të konstatuara si dhe me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në pozicione pune pjesë të shërbimit civil, me aktin nr. 332 prot., datë 18.04.2016, “Për verifikimin e ligjshmërisë së procesit të rekrutimit në shërbim civil, në Bashkinë Tepelenë”, ka filluar kryesisht verifikimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në këtë institucion.

Procesi u realizua nëpërmjet vizitës në Bashkinë Tepelenë nga grupi i punës, i autorizuar nga Komisioneri për të kryer hetim administrativ, sipas objektit të verifikimit. Institucioni u njoftua për fillimin e procesit, me shkresën nr. 332/1 prot., datë 18.04.2016 “Njoftim për fillimin e verifikimit”.

Bashkia e Tepelenës, është organ i qeverisjes vendore, i konstituuar pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015 dhe organizohet e funksionon, bazuar në ndarjen administrativo-territoriale të

specifikuar në rubrikën Qarku Gjirokastrë, Qyteti Tepelenë, të ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

Sipas përcaktimeve të ligjit të mësipërm, kjo njësi e qeverisjes vendore përbëhet nga Bashkia Tepelenë dhe tre Njësitë Administrative në varësi të saj, të cilat janë Qendër Tepelenë, Lopës dhe Kurvelesh (këto të fundit, ish-Komuna, të cilat janë shkrirë në të).

Këshilli i Bashkisë Tepelenë, me aktin administrativ nr. 06, datë 04.02.2016 “Për Miratimin e buxhetit për vitin 2016”, i ndryshuar me vendimin nr. 14, datë 06.04.2016 “Për një ndryshim në vendimin nr. 06, datë 04.02.2016, “Për Miratimin e buxhetit për vitin 2016”, ka përcaktuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Tepelenë dhe Njërive Administrative nën varësinë e saj.

Në vijim të zbatimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak, kryetari i Bashkisë Tepelenë, bazuar në nenin 64, germa “j”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Vendimin nr. 510, datë 10.06.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, ka nxjerrë Urdhrin nr. 1, datë 21.03.2016, për miratimin dhe implementimin e strukturës dhe organigramës përfundimtare të bashkisë.

Nga përmbajtja e strukturës rezulton se, në këtë bashki dhe njësitë administrative në përbërje të saj, janë në total **220** pozicione pune (180 me kohë të plotë dhe 30 me kohë të pjesshme), ndër të cilët **18** pozicione pune, sipas statusit të përcaktuar në strukturë, janë pjesë e shërbimit civil.

Gjatë procesit të verifikimit në institucion, sipas objektit të inspektimit, në këtë bashki, u konstatuan **3 punonjës**, të cilët janë emëruar në kundërshtim me ligjin, në pozicione pune pjesë të shërbimit civil dhe marrëdhënia e tyre e punës aktualisht, rregullohet sipas përcaktimeve të Kodit të Punës të RSH.

Nga verifikimi rezultoi se, me aktin administrativ nr. 5, datë 21.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Tepelenë, janë emëruar me një akt administrativ kolektiv, **3** punonjës, e konkretisht:

- ******, në pozicionin, “Specialist në Sektorin e Financës”, në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar;
- ******, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Zhvillimit Ekonomik”, në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar;
- ******, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Planifikimit Monitorim të Territorit”, në Drejtorinë Ligjore dhe të Shërbimeve.

Ndërkohë, u konstatua se njësia e burimeve njerëzore e institucionit, me aktin nr. 3, datë 21.03.2016, “Për miratimin e planit vjetor të pranimeve në shërbim civil, Bashkia Tepelenë”, ka planifikuar të fillojë procedurat e konkurrimit për **10 pozicione** pune pjesë të shërbimit civil, në Bashkinë Tepelenë.

Nga përmbajtja e planit të pranimit rezultoi se, janë përfshirë në këtë akt edhe 3 pozicionet e punës të sipërpërmendura, të cilat janë plotësuar në kundërshtim me ligjin, si dhe 7 pozicione pune që aktualisht janë të lira.

Sa më sipër, në subjektin e verifikuar konkludohet se, njësia përgjegjëse e menaxhimit të burimeve njerëzore, ka plotësuar 3 pozicione pune pjesë të shërbimit civil, në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar. Këto emërimet nuk janë kryer sipas një procedure konkurrimi të hapur, e cila është e vetmja mënyrë për të plotësuar pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil, apo lëvizjes paralele e ngritjes në detyrë, procedura të cilat rregullojnë sistemin e karrierës në shërbimin civil.

Në këto kushte, bazuar në nenin 23, pika 4, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në nenin 155/a dhe 116/c, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në referencat kur, aktualisht ka hyrë në fuqi ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ky rast është trajtuar me ligjin e mëparshëm, pasi në nenin 185, “Dispozita kalimtare”, përcaktohet se, “Për procedurat administrative, që kanë filluar para hyrjes në fuqi të këtij Kodi, zbatohen dispozitat e ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, akti administrativ kolektiv për emërimin e 3 punonjësve ***** dhe ***** në pozicione pune pjesë të shërbimit civil, të dalë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji për shërbimi civil, duhet të revokohet, si akt administrativ absolutisht i pavlefshëm.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; e nenin 35, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. T’i kërkoj njësisë përgjegjëse, të drejtojë procesin e rregullimit të ligjshmërisë, për revokimin e aktit administrativ kolektiv nr. 5, datë 21.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Tepelenë, që emëron punonjësen ***** në pozicionin, “Specialist në Sektorin e Financës”, në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, punonjësin ***** në pozicionin “Specialist në Sektorin e Zhvillimit Ekonomik”, në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar dhe punonjësin ***** në pozicionin “Specialist në Sektorin e Planifikimit Monitorim të Territorit”, në Drejtorinë Ligjore dhe të Shërbimeve, si akt administrativ absolutisht i pavlefshëm.
2. Njësia përgjegjëse të organizojë punën, nëpërmjet një plani konkret veprimesh, ku të përcaktojë afatet kohore që do të ndiqen për të zhvilluar procedurat e konkurrimit, sipas planit

të miratuar me aktin nr. 3, datë 21.03.2016, “Për miratimin e planit vjetor të pranimeve në shërbim civil, Bashkia Tepelenë”, të Kryetarit të Bashkisë Tepelenë.

3. Njësia përgjegjëse gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, të kujdeset për të përmbushur rregullat e përcaktuara në kreun IV “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimin Nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike. Në veçanti, njësia përgjegjëse të kujdeset për të respektuar kërkesat ligjore në procedurat si më poshtë:

a) Të krijohen Komisionet përkatëse të pranimit dhe vlerësimit (*Komiteti i Përhershëm i Pranimit për nivelin ekzekutiv, Komiteti për Lëvizjen Paralele dhe Ngritjen në Detyrë*) sipas procedurës që do të ndjekë për të plotësuar pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil. Komisionet e ngritura në këtë rast, kanë për detyrë të kryejnë vlerësimin e kandidatëve pjesëmarrës në konkurrim, ç’ka konsiston në vlerësimin e jetëshkrimit, vlerësimin me shkrim (*përveç lëvizjes paralele*) dhe vlerësimin në intervistën e strukturuar me gojë.

b) Të bëjë publik në faqen zyrtare, “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*” dhe faqen zyrtare të Bashkisë Tepelenë, ose nëse është e mundur, në stendat për publikun, shpalljet si:

- Aktin e shpalljes për të plotësuar një pozicion të lirë pune në shërbimin civil. Të tregohet kujdes që ky akt të përmbajë të dhënat, e përcaktuara në pikën 8, të Kreut II, e pikën 5, të Kreut III, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si dhe të pikës 9, Kreu II, të pikës 4, Kreu VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si: përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës; pranim në shërbim civil; kriteret e përgjithshme; kërkesat specifike të pranimit (*arsimi i lartë përkatës*); dokumentacionin që do të paraqitet, mënyrën dhe procedurën e paraqitjes së kandidaturave; datën për paraqitjen e aplikimit; datën e zhvillimit të konkurrimit; datën për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak; mënyrën e vlerësimit dhe njohuritë, aftësitë apo cilësitë që do të vlerësohen në konkurrim; mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me aplikantët dhe elementë të tjerë ligjor që duhet të përmbajë shpallja.
- Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar nga verifikimi paraprak për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “*lëvizja paralele*” ashtu edhe për fazën e dytë “*pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë*”.
- Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar përfundimisht (*lista përfundimtare*) për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “*lëvizja paralele*”, ashtu edhe për fazën e dytë “*pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë*”.
- Aktin e shpalljes së kandidatit të nxjerrë fitues me më shumë se 70% të pikëve nga Komisioni përkatës.

4. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Tepelenë, të zbatojë vendimin brenda **15 ditëve** nga data e marrjes dijeni, dhe pas mbarimit të këtij afati të dërgojë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, një informacion të detajuar bashkë me aktet përkatëse, për zbatimin e këtij vendimi. Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurremeve, si dhe për çdo problem tjetër që ka të bëjë me administrimin e shërbimit civil, të komunikojë me Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe në rast se has vështirësi në praktikën për realizimin e procedurave specifike në këtë rast, të kërkoj asistencën e nevojshme, me qëllim realizimin e këtyre proceseve në përputhje me ligjin.
5. Zbatimi i procedurave ligjore të përcaktuara në këtë vendim, do të monitorohet nga Komisioneri nëpërmjet grupit të punës që ka realizuar verifikimin në këtë subjekt.
6. Të njoftohet për këtë vendim, Bashkia Tepelenë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA